



An EU funded project

**EU Trade
Policy Project**



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Vlerësimi i Ndikimit për Liberalizim të Tregtisë së Shërbimeve

**‘Shërbimet Profesionale dhe Afariste’
(W120/1.A, B, C, D, F) sa i përket
Negociatave në CEFTA**

Prill 2015

Mbështetur nga:

Këtë publikim e mbështet projekti i BE-së, "Asistencë Teknike Zhvillimit të Mëtutjeshëm të Politikës Tregtare të Kosovës"

**EU Trade
Policy Project**

implemented by:

**Përgatitur nga:**

Artan Xërxa – Projekti i BE-së për Politikën Tregtare

Sytrime Dervisholli – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Mirsad Simnica - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Mohim:

Këtë publikim e ka nxjerrë Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e MTI-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se paraqet pikëpamjet e mbështetësit.

Publikuar nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Rr. Muharrem Fejza

p.n. Lagja e Spitalit

10 000 Prishtinë

Republika e Kosovës



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	6
2	TREGTIA E SHËRBIMEVE – PËRMBLEDHJA E FAKTEVE	
	KRYESORE	8
2.1	Pasqyra e Përgjithshme – Sektorët kryesor dhe shifrat globale - Bilanci i Tregtisë	8
2.2	Shërbimet Profesionale – ‘Profesionet Liberale’	9
2.3	Të Dhënat Bazike	10
2.4	Lloji i shërbimeve (Eksportet/Importet)	11
2.5	Potenciali i rritjes	12
2.6	Nën-sektorët e mbuluar	13
3	METODOLOGJIA	15
4	AKTIVITETET KRYESORE	15
4.1	Rishikimi dhe Burimet e të Dhënave në Kompjuter	15
4.2	Diskutimet me Palët e Interesit	16
4.3	Sfidat Kryesore dhe Mjetet e tyre Juridike	16
5	VLERËSIMI I NDIKIMIT TË LIBERALIZIMIT TË	
	‘SHËRBIMEVE PROFESIONALE’	16
5.1	Ndikimi i Përgjithshëm i Pritur	16
5.5.1	Efektet e pritshme pozitive	17
5.5.2	Efektet e pritshme negative	21
6	KONKLuzionET	22
7	REKOMANDIMET	23
7.1	Për Departamentin e Tregtisë - MTI	23
7.2	Për Ministritë Linjë	23
7.3	Për Asociacionet e Bizneseve dhe Odat	23
7.4	Për Negociatorët e CEFTA-së	24
8	LITERATURA	25

Lista e Shkurtesave

BiP	Bilanci i Pagesës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
ZNBE	Zyra Ndërmjetësuese e Bashkësisë Evropiane
BE	Bashkësia Evropiane
FDI	Investimi i Huaj Direkt
AAK	Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës
ARBK	Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve Kosovar
SHAK	Shoqata e Avokatëve të Kosovës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
SHKACK	Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës
SHTIKK	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës
DT	Departamenti i Tregtisë
TAT	Ekipi për Asistencë Teknike
GPPT	Grupi Punues për Politikë Tregtare
TIS	Tregtia e Shërbimeve
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
ITIS	Tregtia e Shërbimeve Ndërkombëtare

1 HYRJE

Disa zhvillime në tregtinë e shërbimeve ndërkombëtare kanë ndikim të fuqishëm në vendet në zhvillim: Së pari, përhapja në mbarë botën e teknologjive të informacionit (IT) ka krijuar mundësi të reja të eksportit për vendet në zhvillim në shërbimet IT. Së dyti, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të shpallur kohëve të fundit për zbutjen e varfërisë mund të arrihen vetëm nëse shërbimet kryesore ofrohen në mënyrë më efikase në vendet në zhvillim, veçanërisht nëpërmjet liberalizimit të importeve të shërbimeve. Së treti, në Raundin e Dohas (RD) për negociatat tregtare që janë në zhvillim e sipër, është kërkuar nga vendet në zhvillim që zyrtarisht të zotohen për liberalizim të importeve të shërbimeve sipas kushteve të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS). Vendet në zhvillim do të përfitojnë nga liberalizimi i importeve të shërbimeve nëse liberalizimi e rrit konkurrencën në anën e ofertës. Ky është zakonisht rasti për shërbime të prodhuesve, siç janë transporti vendor dhe ndërkombëtar, shërbimet financiare dhe të telekomunikacionit. Heqja e kufizimeve për qasje në treg nga të huajt (përfshirë edhe përmes investimeve direkte) shpesh do të përmirësojë cilësinë e shërbimit apo të ul çmimet dhe në këtë mënyrë të rrisë konkurrueshmërinë ndërkombëtare të industrive përpunuese të fazës finale ("downstream industries"). Shumica e eksporteve të shërbimeve nga vendet në zhvillim, veçanërisht shërbimet IT të transmetuara në mënyrë elektronike, përballen me disa pengesa të importit në vendet e industrializuara. Megjithatë, në bazë të GATS, eksportet e shërbimeve mund të bëhen përmes lëvizjes së përkohshme të personave fizik, p.sh., shtetasit e vendeve në zhvillim të cilët punojnë në vendet e industrializuara, pa u bërë rezidentë atje. Nëse negociatat e Raundit të Dohas për Zhvillim do të rrisin mundësitë për migrim të tillë për punë të përkohshme, përfitimet për vendet në zhvillim mund të jenë tepër të mëdha.¹

Kështu, tregtia e shërbimeve ka shënuar një rrugë të rëndësishme viteve të fundit në Kosovë. Rrënjët e potencialit eksportues të Kosovës janë vendosur nga shërbimet e thjeshta TIK dhe Qendrat e Thirrjeve deri tek zgjidhjet shumë të sofistikuara të menaxhimit të rrjetit në largësi, të cilat ju kanë ofruar kompanitë vendore klientëve jashtë vendit. Tregtia e Shërbimeve (TIS) vazhdon të jetë një fushë e rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë. Disa shërbime të natyrës së re kanë depërtuar dhe kanë fituar një pjesë të rëndësishme të tregut kryesisht duke eksportuar shërbimet e tyre (p.sh. qendra për mbështetje të konsumatorëve, aktivitetet e telemarketingut, shërbimet për zhvillimin e softuerëve, shërbimet e udhëtimit dhe turizmit, shërbimet mjekësore, etj) duke i bërë shërbimet e Kosovës më tërheqëse nga perspektiva e tregtisë në shkallë ndërkombëtare.

Kosova, tash e sa vite ka pasur bilanc tregtar pozitiv në shërbime, duke kontribuar kështu në rritjen e brendshme ekonomike kryesisht me punësim të grupeve të ndjeshme dhe rinisë në disa sektorë kyç, gjë e cila e nxit këtë tendencë pozitive siç janë: shërbimet TIK, Qendrat e Thirrjeve,

¹ Burimi: Lücke, Matthias; Spinanger, Dean (2004) : Liberalizimi i tregtisë së shërbimeve ndërkombëtare: Sfidat dhe mundësitë për vendet në zhvillim, Kieler Diskussionsbeiträge, Nr. 412

Agjencitë Turistike, shërbimet e Kontabilitetit dhe Auditimit, Juridike, etj. Në bazë të shifrave të BQK-së² dhe Bazës së të Dhënave TIS, vlen të përmenden shifrat në vijim, të cilat tregojnë bilanc pozitiv në Tregtinë në Shërbime: 2012 u shënua me 265 milion Euro, 2013 me 346 milion Euro dhe 2014 me 138.2 milion Euro. Kështu, mesatarja trevjeçare ka arritur në 249.73 milion Euro. Kjo shifër mesatare vjetore simbolike mund të konsiderohet si ulje për rreth 11.4% të deficitit të përgjithshëm tregtar të Kosovës, i cili aktualisht vlerësohet në rreth 2.2 miliard euro në vit.

Sa i përket Shërbimeve profesionale në veçanti, shifrat e tre kuartalëve të vitit 2014 për tri fushat kryesore të shërbimeve profesionale (shërbimet afariste dhe shërbimet e telekomunikacionit / kompjuterike) treguan një bilanc pozitiv tregtar në shumën prej 30.16 milion Euro (shih Tabelën 1). Vetëm kjo kategori është tregues i rëndësishëm apo i rëndësisë së këtyre shërbimeve në ekonominë vendore.

Liberalizimi i tregtisë në shërbime në nivel të CEFTA-së janë iniciuar me raundin e parë të bisedimeve të planifikuara për nëntor 2014. Është përgatitur një udhërrëfyes i qartë për gjashtë raundet dhe negociatat e bazuara në sektorë të veçantë do të zhvillohen prej nëntorit 2014 deri në mars 2016. Raundi i parë i negociatave (shërbimet profesionale dhe afariste) u zhvillua me 6 nëntor, 2014 në Shkup, Maqedoni. Në takim morën pjesë përfaqësuesit e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Moldovës, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës. Çdo pale është dashur të përgatisin ofertat e tyre në sektorë të ndryshëm për shërbimet profesionale dhe afariste. Oferta specifikonte kufizimet në qasjen në treg dhe kufizimet në trajtim kombëtar për të huajt në bazë të 4 Mënyrave të Ofertës të rregullave GATS. Në bazë të asaj, në ofertën tone kemi cekur nivelin e liberalizimit për çdo sektor dhe nën-sektor.

Negocimi i shërbimeve profesionale është një nga gurthemet e një marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe për shkak të rëndësisë dhe lidhjes së saj me të gjitha kategoritë tjera sipas listës së sektorëve W-120 (shih Shtojca 2). Prandaj është shumë i rëndësishëm tregu prej 24 milion banorësh (anëtarët e CEFTA-së) të cilët kanë qasje të ofrojnë shërbime profesionale dhe afariste, pasi shuma totale e eksporteve vlerësohet të jetë €2.43 miliard. Edhe pse tregu i Kosovës është ende i brishtë dhe me pak përvojë në shumë sektorë, liberalizimi i tregtisë së shërbimeve do t'u mundësojë ofruesve të saj të shërbimeve dhe fuqisë së kualifikuar punëtore të lëvizin lirshëm në treg më të madh dhe rritje të të ardhurave nga eksporti dhe të ndryshojnë bilancin negative në tregti. Në kapitullin pesë i kemi shpjeguar efektet ndërmejt secilit anëtar të CEFTA-së dhe avantazhin e tyre krahasues.

² Burimi Banka Qendrore e Kosovës – Shërbimet Q3 2014

2 TREGTIA E SHËRBIMEVE – PËRMBLEDHJA E FAKTEVE KRYESORE

2.1 Pasqyra e përgjithshme – Sektorët kryesor dhe shifrat globale – Bilanci Tregtar

Shërbimet e eksporteve janë kontribues i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës. Kosova është eksportues neto i shërbimeve. Në dhjetëvjeçarin e fundit, eksporti i shërbimeve ka qenë shumë më i lartë se importi dhe për disa vite ndryshimi ishte pothuaj dy here më i lartë se shifrat e importit (shih tabelën 1). Midis 2005 dhe 2014 Kosova ka eksportuar mbi €5 miliard në shërbime, ndërsa bilanci pozitiv tregtar arriti në €1.9 miliard. Mesatarisht, në të njëjtën periudhë, për çdo vit eksportet e shërbimeve të Kosovës ishin rreth €512 milion, ndërsa importet mesatare të shërbimeve ishin rreth €321 milion. Realizimi i shërbimeve ndërkombëtare ishte veçanërisht i mirë viteve të fundit; në 2014 eksportet e shërbimeve kanë arritur kulminacionin në Kosovën e pasluftës, me €767 milion, ndërsa në vitin 2013, eksportet e shërbimeve të Kosovës arritën €632 milion. Në përgjithësi, sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2013 eksporti i shërbimeve ka përfaqësuar më tepër se 12 përqind të PBB-së, ndërsa importet u llogaritën në rreth 6 përqind të PBB-së.

Tabela 1 – Tregtia e shërbimeve të Kosovës, € mil., 2005-2014

Viti	Kredi (Eksporti)	Debi (Importi)	Bilanci
2005-2010	2,455.20	1,780.70	674.50
2011	625.20	368.90	256.30
2012	641.40	317.60	323.80
2013	632.50	320.30	312.20
2014	767.20	431.30	335.09
Totali 10 vjet, 2005-2014	5,121.50	3,218.80	1,902.70
Mesatarja vjetore, 2005-2014	512.15	321.88	190.27

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës - Shërbimet - <http://www.bqk-kos.org/?id=55>

Në vitin 2014, dy kontribuesit kryesor në eksportin e shërbimeve ishin sektori i udhëtimeve me mbi €504 milion dhe shërbimet e komunikimit dhe ato kompjuterike me mbi €77 milion (shih tabelën 2 në vijim). Sektori i udhëtimeve ka të bëjë kryesisht me me fluksin e Diasporës së Kosovës gjatë vizitave të tyre sezonale. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, tendenca pozitive është duke vazhduar; në tre muajt e parë të vitit 2015 në sektorët e njëjtë të përmendur më lartë. Megjithatë, këta sektorë kryesor, gjegj. shërbimet e udhëtimit dhe komunikimit/kompjuterike përbënin 75.5 përqind të eksportit total të shërbimeve për vitin 2014.

Tabela 2 – Sektorët e shërbimeve kryesore në Kosovë, € mil., 2014

Sektorët	Eksportet	Importet	Bilanci
Udhëtimi	504.20	125.50	378.70
Komunikimi	77.70	58.20	19.50
Ndërtimtaria	12.00	7.70	4.30
Shërbimet profesionale	75.00	66.80	8.20
Shërbimet e sigurimit	21.80	35.91	-14.11
Shërbimet qeveritare	34.70	20.60	14.10

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës - Shërbimet – <http://www.bqk-kos.org/?id=55>

2.2 Shërbimet Profesionale – Profesionet ‘Liberales’

Shërbimet profesionale, të njohura edhe si "profesione liberale" në përgjithësi përkufizohen si profesione për të cilat nevojitet trajnim i veçantë në artin e shkencave, si avokatët, inxhinierët, arkitektët dhe kontabilistët. Disa nga këto profesione rregullohen drejtpërdrejtë nga qeveritë kombëtare, shpesh të mbështetura nga organet profesionale, me kufizime të ndryshueshme në numrin e hyrjeve në profesion, normat e çmimeve, forma e biznesit, të drejtat ekskluzive të cilat i gëzojnë ekspertët. Një rregullim i tillë mund të pengoj performansën e këtyre sektorëve, me kosto të parëndësishme për konsumatorë dhe biznese përpunuese të fazës finale (downstream businesses)³.

Në Kosovë, këto "profesione liberale" kanë mjaft të dhëna të fundit, për shkak të ish sistemit centralist, që ishin në shërbim të këtyre fushave në nivel qendror dhe komunal (n.m.tj. certifikimi i dokumentacionit, përfaqësimi i çështjeve penale dhe civile në gjykata nga avokatët, arkitektët dhe inxhinierët komunal, shërbimet e kontabilitetit qendror komunal, etj.)

³ http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/

Kohëve të fundit këto shërbime janë përmirësuar dhe standardizuar më tej disi me mbështetje të Qeverisë, përkatësisht donatorëve, lidhur me Noteritë, Përmbaruesit Privat, Kontabilistët dhe Auditorët e Certifikuar, etj).


2.3 Të Dhënat Bazike

2.3.1 Të dhënat nga tabela e Shërbimeve/TIS-BQK

Sektorët kryesor që drejojnë realizmin e Shërbimeve Profesionale janë kryesisht: Shërbimet Juridike, shërbimet e Kontabilitetit dhe Auditimit, shërbimet Inxhinierike dhe Arkitekturale dhe Shërbimet Kompjuterike. Në bazë të të dhënave të disponueshme të marra nga BQK gjatë përgatitjes së Bazës së të Dhënave TIS dhe përmirësimit të saj të mëtutjeshëm, tabela në vijim dhe grafiku përkatës përshkruajnë vlerat kyçe të Bilancit Tregtar të disa sektorëve në këtë kategori.

Tabela 3 – Bilanci Tregtar i Shërbimeve Profesionale dhe Afariste prej Q1- 2012 deri Q4-2013*

Value (SUM) - EUR (millions)				Quartal										
WTO/120 Code	Description of the WTO/120 Code	TXN Type	Mode	2012-Q1	2012-Q2	2012-Q3	2012-Q4	2013-Q1	2013-Q2	2013-Q3	2013-Q4	2014-Q1	2014-Q2	2014-Q3
01	BUSINESS SERVICES	Balance	0	0.71	4.35	-1.72	42.49	-4.89	6.72	12.14	-5.59	11.73	13.08	11.17
01Ab	Accounting, auditing and bookkeeping	Balance	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
01Ad	Architectural services	Balance	0	0	0	0.87	1.44	-0.88	0.11	0.13	-0.25	-1.07	0	0
01B	Computer and Related Services	Balance	0	0	0	0.67	-10.5	-0.37	-0.81	0	0	-1.7	-0.68	-2.37
Grand Total				0.71	4.35	-0.19	33.43	-6.14	6.02	12.28	-5.85	8.96	12.4	8.8



*Burimi – Pjesa 1 Baza e të Dhënave TIS – të dhënat nga BQK

Nga tabela e mësipërme vërejmë se në bazë të të dhënave në dispozicion, disa kuarter kanë një farë tendence ciklike me bilancet negative deri në -6.14 Milion Euro në Q1 2013 dhe ato pozitive me deri në +33 milion Euro në Q4 të vitit 2012. Në përgjithësi, siç u përmend më herët, ky sektor ka bilanc kryesisht pozitive të tregtisë gjatë viteve të fundit.

2.4 Lloji i shërbimeve (Eksportet/Importet)

2.4.1 Eksportet

Kosova ka shënuar hapa të rëndësishëm në eksportimin e shërbimeve në disa sektorë dhe nën-sektorë, gjegjësisht shërbimet TIK ku përfshihen midis tjerash Zhvillimi i Softuerit dhe Testimi, Krijimi i Aplikacionit Web dhe Mobil, Shërbimet për Menaxhim të Rrjetit, Qendrat e Thirrjes dhe Shërbimet e Telemarketingut etj. Përveç kësaj, sektori i Udhëtimeve ka pësuar rritje, kryesisht për shkak të pranisë ndërkombëtare dhe diasporës së Kosovës gjatë sezonës së verës dhe dimrit. Gjithashtu, shërbimet profesionale që janë objekt i kësaj analize kanë pësuar një rritje të qëndrueshme dhe ekziston mundësia për zgjerim shtesë, me kusht që lëvizja e lirë e personave dhe subjekteve fizike të mundësohet me anë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe në nivel të CEFTA-s dhe BE-së. Kategoria e fundit gjithashtu do të përfitoj nga rritja e ofertës brenda vendit me cilësinë e përmirësuar të shërbimeve, ndërsa shumica e shërbimeve kanë potencial për eksport duke pasur parasysh efektivitetin e kostos së tyre dhe sistemet e përmirësuara teknologjike, duke kontribuar kështu në rritjen e brendshme të përgjithshme në Kosovë.

Mënyrat kryesore të ofertës të këtyre eksporteve të shërbimeve kanë qenë kryesisht në: Mënyrën 1 – Oferta Ndërkufitare, Mënyrën 2 - Konsumi Jashtë Vendi. Mënyrën 4 – Prania e përkohshme

e personave fizik ka pësuar shumë sfida që lidhen kryesisht me regjimin e vizave për punëtorët kosovar.

2.4.2 Importet

Pavarësisht nga niveli mjaft i qëndrueshëm i shërbimeve të eksportuara, disa sektorë patën nevojë të rëndësishme për t'i importuar ato, të cilat kryesisht lidhen me mungesën e disa shërbimeve ose aftësive të veçanta në nivel lokal. Shembull më i mirë është importi i softuerëve, gjegj. softuerët financiar dhe teknik.

Përveç kësaj, shërbimet juridike dhe të auditimit kanë pësuar import të vazhdueshëm kryesisht nga vendet fqinje, sidomos nga Shqipëria. Në këtë sektor, Mënyra 3 – Prania Komerciale ka qenë mjaft e dukshme përveç në Mënyrën 4 - prania e përkohshme e personave fizik. Rastet e tilla përfshinin kryesisht importin e shkathtësive për nevoja të veçanta, përkatësisht në të Drejtën Tregtare - interpretimi dhe analiza në kategorinë e shërbimeve ligjore, dhe Auditimi në veçanti gjatë periudhës përkatëse kur ai është realizuar, kryesisht, sipas kërkesave të sektorit financiar.

Kështu, numri i individëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë brenda Kosovës po rritet, në njëfarë mënyre ndjehet mungesa e aftësive apo certifikimit të veçantë për të përmbushur kriteret për disa shërbime konkrete profesionale, disa prej të cilave përmenden më lart.

2.5 Potenciali i rritjes

Në bazë të shifrave të lartpërmendura, është mjaft i rëndësishëm potenciali i rritjes së shërbimeve të tregtueshme në Kosovë. Duke pasur parasysh perspektivën e liberalizimit të tyre, llogaritet se ato rriten në mënyrë eksponenciale për të shtuar më tej vëllimin, veçanërisht të eksportit të shërbimeve nga Kosova.

Ky liberalizim i mundshëm me vendet e CEFTA-s, si dhe sipas marrëveshjes së MSA-së që pritet të lidhet së shpejti me Bashkësinë Evropiane, do të ketë nevojë edhe për shërbimet e menaxhimit të cilësisë dhe kualifikime të larta në mënyrë që të konkurrojnë me shërbimet tjera të ofruara globale (gjegj. në sektorin TIK, etj). Kjo sfidë duhet paralelisht të adresohet nga institucionet përkatëse në mënyrë që të përgatiten të diplomuarit e rinj në sektorin e caktuar për certifikime dhe kualifikime të ndryshme, të cilët kontribuojnë në çdo reduktim të mungesës së kualifikimeve ose mospërputhjen eventuale në disa sektorë.

Në këtë kontekst, vlerësohet se në sistemin arsimor të Kosovës ka mangësi sa i përket trajnimeve dhe certifikimeve të specializuara. Një shembull i kësaj mospërputhje eventuale mund të jetë sektori TIK me shumë potencial për rritje, megjithatë për shkak të sistemit arsimor të lartë jo aq mirë të përshtatur, shumë gjeneralist po vihen në tregun e punës, ndërsa industria e TIK ka nevojë gjithnjë e më shumë për fuqi punëtore më të specializuar.

Shembull tjetër mund të jetë numri i studentëve të diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, i cili është në mospërputhje të madhe me nevojat e tregut për këtë kategori të juristëve të ardhshëm në të gjitha kategoritë.

2.6 Nën-sektorët e mbuluar

2.6.1 Shërbimet Juridike

Mjedisi aktual operativ dhe ligjor & Perspektiva e rritjes

Shërbimet Juridike në Kosovë janë themeluar që në fillim të viteve të 1990-ta, pas një epoke të shërbimeve centraliste të kësaj natyre deri atëherë. Rrënjët e këtyre shërbimeve janë shënuar me çështjet civile që kanë të bëjnë kryesisht me çështjet e pronësisë, duke bërë kalimin nga sistemi i vjetër në atë të ri me shumë transaksione private dhe publike, shpesh duke përfshirë komunikimin ndërkufitar. Pra, mund të themi se ka mjaft njohuri për shërbime juridike në çështjet civile dhe penale (shërbime të shkëmbyera brenda vendit). Megjithatë, për çështjet tregtare që kanë të bëjnë me ligjet, interpretimet dhe kujdesin e duhur, nuk ka aq shumë ofruesë të shërbimeve si në të dy kategoritë e lartpërmendura. Pavarësisht nga ky fakt, ofruesit e shërbimeve juridike janë ata që eksportojnë shërbimet që nga viti 2000 me rritje të pranishme ndërkombëtare tregtare dhe civile në Kosovë. Në ditët e sotme, një nga aktivitetet e tyre kryesore lidhet me aspektet e privatizimit, zhvillimin e pasurive të patundshme, etj. Kështu, potenciali për rritje në këtë kategori sa i përket shërbimeve të tregtueshme ka të bëjë direkt me shkallën e IHD-ve dhe rritjen e brendshme ekonomike, e cila për fat të keq ka pësuar rënie viteve të fundit në Kosovë.

2.6.2 Kontabiliteti dhe Auditimi

Mjedisi aktual operativ dhe ligjor & Perspektiva e rritjes

Kontabiliteti dhe Auditimi në Kosovë i ka pasur dy rrugë të ndryshme. Kontabilitetin dhe llogari-mbajtjen e ka shënuar një grup i profesionistëve relativisht të aftë dhe kompetent, që kryesisht vinin nga sistemi centralist i ish-Jugosllavisë në fillim të viteve të 1990-ta, që njihet si llogari-mbajtje manuale. Me krijimin e ndërmarrjeve të vogla private në vitet e 1990-ta, ky profesion u bë i rëndësishëm, sepse shumë ndërmarrës nuk kishin njohuri për të. Kështu, pas vitit 1999 me ndryshim të sistemit dhe valutës, këto shërbime u bënë edhe më të kërkuara edhe për faktin e rimëkëmbjes pas luftës dhe zhvillimit të NVM-ve private.

Për pjesën e Auditimit, deri në vitin 2000 me themelimin e bankës së parë private në Kosovë, nuk ka pasur kërkesa për auditim të ndërmarrjeve të vogla kryesisht të formuara në vitet e 1990-ta. Prandaj, me praninë e shtuar të bankave komerciale të cilat numërojnë sot nëntë prej tyre në Kosovë, automatikisht ngritët nevoja për auditorë me përvojë dhe të certifikuar. Gjithashtu, nga kompanitë publike është kërkuar të shfrytëzojnë shërbime të ngjashme të auditimit krahasuar me shfrytëzimin e mëparshëm në nivel qendror në ish-Jugosllavinë socialiste.

Prandaj, këto dy profesione kanë nevojë të vazhdueshme për ekspertë me kualifikim të lartë me qëllim që të plotësohen nevojat e bizneseve. Vlerësohet se potenciali i rritjes në këtë sektor është shumë i madh, duke pasur parasysh rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe praninë shtesë të kompanive dhe korporatave të huaja.

2.6.3 Shërbimet Kompjuterike dhe të Ngjashme

Mjedisi aktual operativ dhe ligjor & Perspektiva e rritjes

Si në shumicën e vendeve të botës, edhe në Kosovë janë paraqitur shërbimet kompjuterike, kryesisht me paraqitje fillestare të kompjuterëve PC dhe më vonë të zgjeruar në fillim të vitit 2000 me arritjen e internetit dhe zgjidhjet e menaxhimit të rrjetit.

Kosova ka pasur gjithmonë një mori aftësish solide për këto shërbime, si për harduer, ashtu edhe softuer. Në dhjetë vitet e fundit, pjesa e shërbimeve për PC-të dhe telefonat e mençur ka pësuar rritje shumë të shpejtë me mundësi të shërbimeve plotësuese për të plotësuar kërkesat e shfrytëzuesve. Industria TIK në Kosovë ka pësuar rritje shumë të shpejtë kryesisht me shërbimet e tregtueshme siç janë: zhvillimi dhe testimi i softuerit, zgjidhjet për menaxhim të rrjetit, krijimi i aplikacioneve për platforma të telefonave të mençur, tele-marketingu dhe qendrat e ndihmës, etj.

Falë evolucionit teknologjik, kjo kategori është shpesh përfituesi kryesor i eksporteve për Kosovë, e nxitur nga shërbimet e lartpërmendura, të cilat ofrohen të shumtën e kohës në Mënyra 1 – oferta ndër-kufitare në formë elektronike.

Potenciali për rritje është real në këtë sektor, duke pasur parasysh numrin e madh të individëve të rinj dhe të aftë, të cilët janë shtylla e këtyre kompanive që eksportojnë shërbime nga Kosova.

Mirëpo, qeveria e Kosovës dhe Shoqata e TIK duhet të jenë më pro-aktive për të kërkuar ndërmarrjen e kurseve shumë të specializuara/certifikatave për individë të sapo diplomuar që vijnë nga shkollat e mesme ose universitetet.

2.6.4 Shërbimet Arkitekturale dhe Inxhinierike

Mjedisi aktual operativ dhe ligjor & Perspektiva e rritjes

Shërbimet arkitekturale dhe inxhinierike në Kosovë kanë pësuar rritje të madhe prej viteve të 1990-ta me transformimin e pronës dhe numrin e madh të ndërtimeve të bëra nga diaspora në këtë dekadë. Përveç kësaj, këto shërbime janë zgjeruar më tej me fazën e rindërtimit të pasluftës në fillim të vitit 2000.

Mjedisi i tanishëm operativ dominohet nga aktivitetet e ndërtimit për banim në të gjitha qytetet kryesore dhe në kryeqytet - Prishtinë. Duke pasur parasysh numrin e lartë të aktiviteteve të ndërtimit, si dhe institucionet qeveritare dhe komunat mjaft të dobëta, shumë shërbime profesionale dhe kritere, të cilat kërkohen nga arkitektët dhe inxhinierët, kanë devijuar nga standardet dhe aspektet e menaxhimit të cilësisë.

Duke pasur parasysh disa barriera dhe aspekte të menaxhimit të cilësisë, të cilat nuk i kanë përmbushur profesionistët kosovar, potenciali për rritje të eksportimit të shërbimeve të tilla mbetet në harresë për momentin.

3 METODOLOGJIA

Për qëllime të këtij Dokumenti për VN, janë ndërmarrë hapat kyç në vijim për të mbuluar çështjet më të rëndësishme dhe për të shfrytëzuar praktikatat më të mira sa më shumë të jetë e mundur.

- ☒ Rishikim i dokumentacionit ekzistues dhe praktikave më të mira për një ushtrim të ngjashëm për Vlerësim të Ndikimit lidhur me negociatat e tregtisë së shërbimeve në nivel bilateral dhe multilateral;
- ☒ Konsultime direkte me palët kryesore të interesit – ministritë dhe asociacionet;
- ☒ Një seminar jashtë Prishtinës për të shqyrtuar pozitën e krijuar fillimisht në bazë të konsultimeve dhe reagimeve të marra;
- ☒ Rishikim i seancave të negociatave në CEFTA duke plotësuar mangësitë e duhura dhe duke modifikuar ofertat përkatëse për çdo nën-sektor/kategori;
- ☒ Shqyrtim i brendshëm nga stafi i DT/MTI i inputit plotësues dhe komenteve sipas nevojës;
- ☒ Konsultime të brendshme të ngushta të Drejtorit dhe zyrtarëve të DT me ekspertët e Projektit lidhur me Dokumentin e VN;
- ☒ Analizat e të dhënave për sektorë/nën-sektorë formojnë Bazën e të Dhënave TIS dhe BQK të publikuara në format të BtP, përfshirë krahasimin me vendet tjera të rajonit për të shqyrtuar ndikimin e liberalizimit të shërbimeve në këta sektorë;
- ☒ Rishikim i hollësishëm i dokumenteve tjera dhe praktikave më të mira në përshkrimin e VN të Shërbimeve Profesionale në drejtim të perspektivës së negociatave multi-laterale;

Duke pasur parasysh se kjo është hera e parë që **po bëhet një Vlerësim i Ndikimit në Tregtinë e Shërbimeve**, ky dokument fillestar do të shërbej edhe si rrugë shtytëse për **vlerësim të ardhshëm të sektorëve dhe përmirësimin e mëtejme bashkë me kontributet shtesë**.

4 AKTIVITETET KRYESORE

Negociatat për shërbime midis vendeve të CEFTA-s (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova) kanë filluar në korrik të vitit 2014 me fokus kryesor në shërbime profesionale, ndërsa negociatat kanë përfunduar në nëntor 2014 dhe shkurt 2015 duke mbyllur kështu një fazë të parë të rëndësishme drejt liberalizimit gradual të shërbimeve të bazuara në sektor midis vendeve të CEFTA-së.

Para dhe gjatë këtij procesi, MTI-ja ka përpiluar një agjendë se si të vazhdohet më tej dhe të nxjerret më e mira nga ky proces. Përveç kësaj, do të shpjegohet procesi i konsultimeve dhe burimeve që ndihmuan në hartimin e ofertës së Kosovës për negociata.

4.1 Rishikimi dhe Burimet e të Dhënave në Kompjuter

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, burimet kryesore ishin Banka Qendrore e Kosovës përmes Bilancit të Pagesave dhe të dhënave statistikore në dispozicion nga viti 2004 deri tani; Bazat e të Dhënave TIS n.m.tj. 1) baza e të dhënave statistikore; 2) baza e të dhënave të legjislationit; 3) Akterët kryesorë (bizneset); 4) barrierat për vendet e treta dhe 5) interesi difensiv

dhe ofensiv; dokumentet e Bankës Botërore si "Barrierat në Tregtinë e Shërbimeve në Rajonin e CEFTA-s" dhe "Negociatat për Tregtinë e Shërbimeve, udhëzuesi për vendet në zhvillim" ishin referencë e mirë për t'u trajtuar në këtë dokument. Praktikën më të mira për negociatat të ngjashme multilaterale ishin një tjetër perspektivë që e kemi marrë në konsideratë për shkak të rëndësisë së këtij procesi në afat të gjatë.

4.2 Diskutimet me Palët e Interesit

Pasi shërbimet profesionale kryesisht prekin shoqatat profesionale, MTI-ja ka zhvilluar takime me Odën e Avokatëve, Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës, Shoqatën e Arkitektëve, Shoqatën e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit, Odën e Mjekëve të Kosovës dhe ministritë linjë të cilët janë përgjegjëse për sektorët e shërbimeve profesionale. Qëllimi i këtyre takimeve ishte të hartohet një pozicion për katër mënyrat e ofertës n.m.tj. oferta ndërkuftare; konsumi jashtë vendit, prania komerciale dhe prania e personave fizik dhe për të marrë pëlqimin përfundimtar nga palët me interes rreth pozicionit negociues të Kosovës për shërbime profesionale.

Përveç kësaj, MTI-ja, me ndihmën e Projektit të BE-së, ka mbajtur dy seminarë jashtë Prishtinës për të lehtësuar më tej procesin e hartimit të ofertës së Kosovës për negociatat. Pjesëmarrësit ishin nga ministritë linjë dhe shoqatat profesionale.

4.3 Sfidat Kryesore dhe Mjetet e tyre Juridike

MTI-ja ka mbledhur informata të rëndësishme para dorëzimit të ofertave për liberalizim të shërbimeve profesionale dhe afariste në vendet e CEFTA-së. Përveç krijimit të kanaleve të duhura të komunikimit me palët kryesore të interesit brenda dhe jashtë qeverisë, si dhe përgatitjes për regjistrim të plotë të masave përkatëse për të siguruar se kuptohet si duhet regjimi rregullator dhe mangësitë e tij të mundshme, MTI-ja ka identifikuar mundësitë dhe sfidat me të cilat janë përballur eksportuesit; ka përcaktuar nevojat për ngritjen e kapaciteteve të ministrive dhe agjencive rregullatore.

Sfida e mbetur është ende mungesa e forumit të duhur koordinues, përkatësisht Grupit Punues Kombëtar për Shërbime, të cilin do ta udhëheq Departamenti i Tregtisë i MTI-së, për të nxitur ndryshimet e nevojshme në legjislacion dhe për të paraqitur procesin e negociimit dhe vendimet në mënyrë të formalizuar me veprime të qarta dhe duke ndjekur realizimin e tyre nga institucionet dhe palët përkatëse me interes. Kështu, DT-ja së shpejti do të propozoj krijimin e këtij forumi në Zyrën e Kryeministrit duke përdorur procedurat e rregullta të qeverisë.

5 VLERËSIMI I NDIKIMIT për LIBERALIZIM TË 'SHËRBIMEVE PROFESIONALE'

5.1 Ndikimi i Përgjithshëm i Pritur

Vlerësimi i ndikimit për liberalizim të shërbimeve në Kosovë nuk është një detyrë e lehtë sepse ato kanë tendencë të jenë komplekse dhe sfiduese. Liberalizimi i shërbimeve vlerësohet krejt

ndryshe nga tregtia e mallrave. Në vend të krahasimit të niveleve tarifore para dhe pas marrëveshjes tregtare, shërbimet, nga ana tjetër, janë shkalla në të cilën largohet trajtimi diskriminues midis anëtarëve.

Derisa liberalizimi i tregtisë së shërbimeve ka mundësi të gjenerojë përfitime tek eksportet e larta, nga perspektiva e gjerë e ekonomisë, më të rëndësishme janë përfitimet që dalin për kompanitë, punëtorët e kualifikuar dhe ekonomitë familjare duke pasur qasje në një treg më të madh të cilësisë më të lartë të shërbimeve dhe kosto më të ulët.⁴

Liberalizimi i tregtisë ka edhe implikime të rëndësishme sa i përket bilancit të pagesave. Vendet në zhvillim kanë përfituar shumë në sektorë të ndryshëm duke eksportuar shërbimet e tyre për ndërtim, shërbim bankar, shërbimet IT dhe shërbimet tjera afariste lidhur me rrjetin e telekomunikacionit. Shtetasit që banojnë jashtë vendit në Mënyra 4 e GATS (Prania e Personave Fizik) ose punojnë përkohësisht si punëtorë të kualifikuar, specialistë, apo edhe drejtues të korporatave dhe kompanive multinacionale paraqesin të ardhura të rëndësishme monetare.⁵

Edhe pse Tregtia e Shërbimeve të Kosovës është akoma e re dhe në fazë hulumtuese, eksportet e larta dhe teprica neto kanë rëndësi të konsiderueshme krahasuar me mallrat, për shkak se ajo ul deficitin tregtar në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave.⁶ Nga ana tjetër, liberalizimi i shërbimeve në sektorë të ndryshëm luan rol vendimtar në Mënyra 3 të GATS (Prania Komerciale) në tërheqjen e IHD-ve duke mundësuar qasje pa barriera në një treg më të madh, më konkretisht në Sektorin financiar, të Informacionit dhe Teknologjisë së Komunikimit, Shërbimet Profesionale dhe shërbimet tjera afariste. Me uljen e barrierave, liberalizimi i shërbimeve mund të jep përfitime të konsiderueshme në mirëqenie dhe me ulje të çmimeve të diferencës midis shërbimeve të brendshme dhe të jashtme të Kosovës, ai do të rrisë mirëqenien, ka mundësi të jetë ngjashëm me liberalizimin e mallrave tregtare.⁷ Për vendet në zhvillim, përfitimet e mirëqenies llogaritet të jenë dy deri tre herë më të larta në raport me të ardhurat kombëtare se sa në vendet e zhvilluara.

5.5.1 Efektet e pritshme pozitive

Zhvillimi i internetit dhe kompanive të rrjetit kombëtar të cilat ofrojnë shtrirje të gjerë të shpejtësisë së lartë, u ka mundësuar në veçanti shumë të rinjve të Kosovës të ofrojnë ekspertizën dhe aftësitë e tyre përmes Mënyrës 1 (Oferta Ndër-kufitare). Pasi është e vështirë të sigurohen statistika të veçanta, sipas Statistikave për Tregti Ndërkombëtare të OBT (2008), shërbimet profesionale dhe afariste janë më të realizuarat në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Eksportet e shërbimeve vetëm të Bashkësisë Evropiane në vitin 2006 përbënin \$260 miliardë vlerë në shërbimet afariste, profesionale dhe teknike duke e radhitur BE-në si eksportuesin më të madh botëror.

⁴ Francois dhe Hoekman (2010) analizojnë literaturën empirike të kohëve të fundit ku vlerësojnë efektet e tregtisë dhe konkurrencës më të madhe në produktivitet të firmave të cilat shfrytëzojnë shërbimet si inpute.

⁵ Lehmann, Tamirisa dhe Wiczorek, p.3

⁶ BQK, BiP (2014)

⁷ Lehmann, Tamirisa dhe Wiczorek, f.10

Shërbimet arkitekturnale dhe inxhinierike përbëjnë 19 përqind, ato juridike, të kontabilitetit, menaxhimit dhe konsultimit 18 përqind, ndërsa shërbimet e hulumtimit dhe zhvillimit 16 përqind. Të gjithë këta sektorë kanë siguruar pjesën më të madhe të eksporteve nga BE-ja në vendet tjera. Në Indi, Brazil dhe Kinë, shërbimet profesionale përbëjnë 45 përqind të eksporteve, duke arritur në total \$20 miliard⁸.

Në vendet e CEFTA-së që përfshijnë shtatë anëtarë: Shqipëria, Kosova, Moldova, Mali i Zi, Bosnja, Serbia dhe IRJ e Maqedonisë, eksportet e shërbimeve profesionale dhe afariste ndryshojnë nga vendi në vend. Tabela 2.1 thekson në veçanti këtë ndryshim midis eksportuesit më të madh dhe më të vogël. Eksportet më të larta i ka bërë Serbia, me vlerë totale prej €1.56 miliard, ndërsa eksportet më të ulëta i ka bërë Bosnja.

Analiza jonë tregon se disa sektorë funksiononin më mirë tek disa vende: në Kosovë, Serbi dhe IRJ e Maqedonisë, sektori më i realizuar ishte *Shërbimet Tjera Afariste*, ndërsa në Shqipëri, Moldovë, Mal të Zi dhe Bosnje sektorët më të realizuar ishin *Shërbimet Profesionale dhe Shërbimet Kompjuterike*.

Sipas të dhënave të OBT-së, në Tabelën 2.1 për tregtinë e përgjithshme të shërbimeve midis vendeve të CEFTA-së, eksportuesi kryesor i shërbimeve të përgjithshme është Serbia me më tepër se €4.3 miliard. Sektorët kyç më të realizuar ishin: Sektorët e Transportit, Telekomunikacionit dhe të Biznesit.⁹ Serbia, si eksportues kryesor i shërbimeve, ka edhe eksportin më të lartë të mallrave të përgjithshme midis anëtarëve të CEFTA-së. Kjo ndërlidhje shoqërohet me këto eksporte të larta krahasuar me vendet tjera rajonale. Kontribues tjetër në këtë avantazh është madhësia e vendit, infrastruktura e mirë, kapacitetet e arsimuara njerëzore në shumë sektorë dhe marrëveshjet bilaterale dhe multi-laterale me vendet tjera.

Nga ana tjetër Shqipëria ka eksportuar më shumë se €2 miliardë në aspektin e tregtisë së përgjithshme të shërbimeve, duke e bërë atë akterin e dytë kryesor në CEFTA. Sektorët kryesorë që paten realizueshmëri më të mirë ishin: Shërbimet e Turizmit, Transportit dhe ato Afariste. Po ta shikojmë tabelën e tendencës, shumica e vendeve të CEFTA-së kanë rritur mjaft eksportet e tyre nga viti 2011 - 2013 pas nënshkrimit të Marrëveshjes mbi Stabilizim dhe Asociim të Bashkësisë Evropiane dhe gjatë anëtarësimit ose pas hyrjes në OBT.

Për Kosovën, nga ana tjetër, tendenca tregon se eksportet e shërbimeve profesionale dhe afariste kanë pësuar rënie çdo vit. Kjo ndodh kryesisht për shkak të IHD-ve të reduktuara (*konsiderohet se më shumë se 80 përqind e investimeve të huaja në Kosovë shkon në shërbime*) dhe deficitit tepër të lartë në mallra, të cilat lidhen shumë me shërbime.¹⁰

Në një treg prej 24 milion banorësh (anëtarët e CEFTA-së) është shumë me rëndësi të ketë qasje për të ofruar shërbime profesionale dhe afariste, sepse vlera totale e eksporteve vlerësohet të jetë €2.43 miliard. Edhe pse tregu i Kosovës është ende i brishtë dhe me pak përvojë në shumë sektorë, liberalizimi i tregtisë së shërbimeve do t'u mundësoj ofruesve të saj të shërbimeve dhe

⁸ OBT – Të Dhënat e Tregtisë Ndërkombëtare dhe Qasjen në Treg (2013)

⁹ OBT – Të Dhënat e Tregtisë Ndërkombëtare (2011-2013)

¹⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK 2010 – 2013)

punëtorëve të kualifikuar të lëvizin lirshëm në një treg më të madh dhe të rrisin të ardhurat e tyre nga eksportet dhe të ndryshojnë këtë bilanc negativ të tregtisë. Megjithatë, për të arritur rezultate maksimale, institucionet qeveritare të Kosovës duhet t'i kushtojnë më shumë kujdes dhe të investojnë shumë në menaxhimin e resurseve njerëzore dhe ngritjen e kapacitetit. Aktualisht, mungesa e arsimimit cilësor në sektorë të veçantë (inxhinieri, IT, mjekësor dhe kompjuterik) nuk mund të nxjerrë burime njerëzore cilësore për të qenë konkurrent në rajon dhe është e domosdoshme të rishikohet plan-programi i arsimit të lartë dhe nxjerrjes së burimeve të kualifikuara njerëzore.

Tabela 2.1 Pasqyra e Eksporteve të Shërbimeve Profesionale dhe Afariste përb. Eksporteve të Shërbimeve në vendet e CEFTA-së në vitet 2011 – 2013.

Shërbimet Profesionale dhe Afariste	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Eksporti total p/vend (2011-2013)	Shërbimet e përgjithshme totale p/vend (Viti 2013)
Vendet e CEFTA-së	në milion € Eksport	në milion € Eksport	në milion € Eksport	në milion € Eksport	në milion € Eksport
Shqipëria	219	152	135	506	<u>2080</u>
Kosova	172	132	104	408	<u>632</u>
Moldova	165	176	215	556	<u>973</u>
Mali i Zi	72	119	156	347	<u>1323</u>
Bosnja & Hercegovina	19.6	21	23	63.6	<u>1146</u>
Serbia	1381	1416	1560	4357	<u>4305</u>
IRJ e Maqedonisë	303	309	315	927	<u>990</u>
Totali (vendet e CEFTA-së)	2331	2325	2436	7092	<u>11449</u>

Burimi: OBT – Të Dhënat e Tregtisë Ndërkombëtare dhe Qasjes në Treg (2011-2013)

Burimi: BQK – Bilanci i Pagesave (Kosovë, 2013)

Pasi tregtia e shërbimeve është sektori më i madh dhe i cili rritet shumë shpejtë i ekonomisë botërore, i cili siguron më shumë se 70 përqind të prodhimit botëror dhe një përqindje të madhe të punësimit në Kosovë, ne theksojmë tri përfitimet kryesore të liberalizimit të shërbimeve, që do të mund të kishin rol vendimtar.

- **Infrastruktura** – një infrastrukturë jo-efikase dhe e shtrenjtë krahasohet me tatimin në prodhim dhe eksporte. Prodhuesit dhe eksportuesit, si të mallrave, ashtu edhe të shërbimeve, ose si i quajmë ne ofruesit e shërbimeve, do të duhet të kenë qasje në shërbimet e klasit botëror në qoftë se duan të jenë të suksesshëm në konkurrim. Firmat do të përballen me vonesa dhe pengesa tjera në të bërit biznes për shkak të standardit të ulët të rrjetit të komunikimit. Prodhuesit nuk do kenë çmime konkurruese nëse duhet të paguajnë kosto më të lartë të transportit dhe nuk kanë qasje në norma më të ulta të interesit në sistemin financiar, në zgjerimin ose mbajtjen e biznesit të tyre. Kjo ndërlidhje midis mallrave dhe shërbimeve aktualisht mungon në Kosovë me anëtarët tjerë të CEFTA-s, dhe të pasurit qasje të lirë në treg pa barriera dhe investime në infrastrukturë, mund ta zhvendos këtë performance nga negative në pozitive.¹¹
- **Kursimet e Konsumatorëve** – liberalizimi i shërbimeve shpie në çmime më të ulëta, cilësi më të mirë dhe zgjidhje më të madhe të shërbimeve. Këto përfitime arrihen përmes sistemit ekonomik dhe ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të ofertave për produkte tjera. Krijimi i barrierave ndaj shërbimeve të huaja është gjithashtu tatim në konsumatorët vendor. Nëse politikat mbrojnë ofruesit e pasuksesshëm, mbrojtja e tillë do të mund të krijoj një ngarkesë të ngjashme tatimore në konsumatorët vendor, të cilët nuk mund të kenë qasje në shërbime më të lira të huaja.
- **Transferi i teknologjisë dhe risive** – kjo është shumë e rëndësishme për shkak se ka të bëjë me Mënyrën 3 (Prania Komerciale). Kompanitë, degët dhe filialet e huaja nxiten të vendosen me praninë dhe kapitalin e tyre në vend. IHD-të e tilla sjellin teknologji dhe aftësi të reja, të cilat zgjerohen në mënyra të ndryshme në ekonomi. Aftësitë dhe teknologjia e fituar nga nëpunësit vendor do të përhapet dhe përshtatet me shumë kompani vendore, duke krijuar kapacitete të burimeve njerëzore. Si rrjedhojë, kompanitë tjera të vogla dhe të mesme që përfituan nga këto risi, do të mund të orvaten të hyjnë në tregun rajonal dhe ndërkombëtar dhe të ofrojnë shërbimet e tyre. Sektorët të cilat kanë mundësi të përfitojnë më shumë janë: sektori i inxhinierisë, kontabilitetit, konsultimit të bizneseve dhe TIK.

Në kontekst të liberalizimit të tregtisë së shërbimeve në CEFTA, në veçanti do të mund të arriheshin efektet pozitive në vijim:

- ☒ Lidh nivelin aktual për liberalizim të regjimit tregtar të shërbimeve të Kosovës me palët tjera kontraktuese;
- ☒ Krijohet qasje e re në treg kryesisht për kompanitë dhe individët e Kosovës kur hyjnë në tregun e palës kontraktuese, do të mund të depërtohej më lehtë dhe me kosto më të ulët në tregjet e jashtme;
- ☒ Shtohet transparenca, parashikueshmëria e regjimit të politikës tregtare të Kosovës dhe palës kontraktuese;
- ☒ Nxiten ofruesit e shërbimeve vendore të shtojnë konkurrueshmërinë për të qenë më konkurrues në krahasim me ofruesit e shërbimeve nga pala tjetër kontraktuese (ulja e shpenzimeve, modernizimi i objekteve, përmirësimi i shërbimeve, zgjidhja superiore e shërbimeve, shërbimet e orientuara në cilësi, etj.)

¹¹ Rëndësia e Infrastrukturës për Tregti dhe Zhvillim, Raporti i Tregtisë Botërore OBT (2004)

- ☑ Ulja e çmimeve për shërbime të ndryshme në treg (edhe kompanitë e Kosovës mund të përfitojnë nga kjo, sepse ato mund të eksportojnë shërbimet me shpenzime më të ulëta për shkak të legjislacionit të ri për TVSH)
- ☑ Shtohet cilësia e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve të Kosovës dhe palës/vendit kontraktues.

5.5.2 Efektet e pritshme negative

Nëse qeveria i merr seriozisht shërbimet dhe negociatat, hapja e tregut të shërbimeve në Kosovë në afat të gjatë do të mund të shpie në përfitime ekonomike, risi dhe ngritje të kapaciteteve njerëzore. Për të pasur mjedis më konkurrues, nevojitet kohë për t'u përshtatur dhe në shumë raste, kjo mund të shkaktoj ngarkesa në procesin e implementimit.

Janë disa sfida që lidhen me liberalizimin e tregtisë së shërbimeve të cilave qeveria duhet t'i kushtojë vëmendje. Në mesin e tyre është presioni nga komuniteti ndërkombëtar për të nxituar në hapjen e tregut vendor të shërbimeve (Mattoo dhe Payton, 2007). Ky rrezik shoqërohet, pa i kushtuar vëmendje rregulloreve të brendshme dhe reformave, me nevojën për të krijuar një grup institucional i cili mund të vlerësoj kornizën rregullative dhe sektorët e shërbimeve që kanë potencial të nxjerrin përfitime nga liberalizimi efikas.

Sfidë kryesore duhet të konsiderohet edhe mungesa e kapaciteteve njerëzore për t'u marrë me çështjet e tregtisë së shërbimeve. Kjo çështje nuk ka të bëjë me negociatat, por më tepër me legjislacionin e Kosovës në disa sektorë ku ka mangësi apo ato nuk rregullohen në bazë të katër mënyrave të ofertës nga rregullat e GATS. Ndoshta sfida më e madhe do të jetë Mënyra 3 (Prania Komerciale) dhe Mënyra 4 (Prania e Personave Fizik), ku shërbimet profesionale në disa sektorë si: inxhinierët dhe arkitektët ende nuk janë të licencuar nga organet institucionale, dhe kjo pengesë nuk u lejon këtyre sektorëve të veçantë të angazhohen në ndonjë bashkëpunim rajonal, sipërmarrje të përbashkët ose edhe ofrim të shërbimeve në mënyrë të pavarur.

Gjatë vlerësimit tonë me këtë dokument, ne kemi kontaktuar institucionet qeveritare, shoqatat e biznesit, odat ekonomike dhe palët tjera me interes për të marrë pikëpamjen dhe përvojën e tyre, kur ata merren me tregtinë e shërbimeve me vendet e CEFTA-s. Në raste të shumta, lëvizja e lirë e personave dhe qasja në tregun rajonal ishin çështjet që prekën rëndë ofruesit dhe bizneset profesionale. Prandaj, nëse zotimet nuk përmbushen për të ulur ose hequr barrierat në listën e konsoliduar të masave ekzistuese diskriminuese ose kufizuese nga palët e CEFTA-s, liberalizimi i shërbimeve nuk do të garantojë qasje të drejtë në tregun rajonal; ai është përplot me masa diskriminuese të cilat mund të ndikojnë në konkurrencë të padrejtë nga vendet tjera dhe ofruesit e tyre të shërbimeve.

Një tjetër sfidë të cilën Kosova e konsideron të madhe është Njohja Reciproke e Kualifikimeve (NRK) nga anëtarët e CEFTA-së. Në shumë raste arkitektët, inxhinierët, kontabilistët dhe mjekët u përpoqën të ofrojnë shërbimet e tyre në rajon, por ata u përballën me pengesa për të hyrë dhe të ofrojnë shërbime të tilla për shkak të legjislacionit të tyre kundër njohjes së diplomave të Kosovës, ose të bazuar në disa masa diskriminuese. Pra, liberalizimi i shërbimeve nuk ka fare kuptim nëse palët nuk i njohin kualifikimet e njëri-tjetrit.

6 KONKLUZIONET

Disa nga konkluzionet dhe mësimet e përgjithshme të mësuara për **mbështetje të shërbimeve të tregtueshme në të ardhmen në kategorinë e Shërbimeve Profesionale** që rrjedhin nga gjetjet e VN janë:

- i. Nevojitet staf më i kualifikuar dhe i specializuar për kategori të caktuara për të plotësuar kërkesën e mundshme, përkatësisht specialistë për TIK të certifikuar në nivelet/programet në shkallë ndërkombëtare (n.m.tj. CISCO, etj);
- ii. Të paraqitet një skemë e sponsorizuar nga Qeveria për shërbimet profesionale/sectorët privat për studentë përkatës. Kjo do të ndihmojë në paraqitjen e mundësisë së praktikës në NVM-të në Kosovë për studentët e biznesit. Kështu, pronari i NVM-së do të mund të shfrytëzojë një praktikant i cili studion në fushë përkatëse në teori dhe angazhohet të mësojë se si funksionon biznesi në praktikë. Nëse praktikanti bën punë të mirë, ka shumë gjasa që pronari i biznesit të dëshirojë ta punësojë studentin pasi ai të ketë diplomuar, duke e bërë këtë qasje të qëndrueshme, por edhe të ndihmojë kompanitë të jenë stabile që të pajisen me aftësi;
- iii. Investitorëve dhe diasporës duhet t'u ofrohet një pako nxitëse për të shfrytëzuar individë me kualifikim të lartë në nën-sektorë të caktuar të shërbimeve profesionale, duke gjeneruar kështu rritje të brendshme shtesë dhe përfshirje aktive të shërbimeve profesionale drejt Liberalizimit të Shërbimeve me CEFTA-në dhe BE-në;
- iv. Duket se nevojitet një forum i specializuar për të diskutuar dhe për t'u pajtuar me pozicionin e Kosovës, për të kanalizuar në mënyrë të strukturuar çështjet të cilat hasen gjatë procesit të negocimit. Ky forum do të mund të ketë formën e një 'Grupi Punues Kombëtar për Shërbimet Profesionale';
- v. Domosdoshmëria për të zhvilluar një proces të diskutimit që shpie në MNR (Marrëveshja mbi Njohjen Reciproke) midis anëtarëve të CEFTA-së, i cili u ndihmon shumë individëve dhe kompanive të ofrojnë shërbime ndër-kufitare në vendet përkatëse;
- vi. Zhvillimi i një procesi për dialog ndër-qeveritar me Ministrinë dhe Agjencinë Linjë lidhur me hapat e nevojshëm

për negociata të shërbimeve përmes një 'Grupi Punues Kombëtar për Shërbime Profesionale';

7 REKOMANDIMET

7.1 Për Departamentin e Tregtisë - MTI

- a. DT duhet të krijoj një Grup Punues Kombëtar për Shërbime Profesionale, i cili do të grupoj kategori të caktuara të rëndësishme (n.m.tj. Avokatë, Kontabilistë, Arkitektë, Inxhinierë, etj) ku institucionet dhe asociacionet përkatëse do të takoheshin një herë në muaj për të përmirësuar aspektet operative dhe ligjore të kësaj kategorie, me veprime dhe mbështetje të qarta për të përmirësuar këtë kategori të shërbimeve;
- b. DT duhet të emëroj një Zyrtar të Lartë për shërbime për të udhëhequr procesin e Koordinimit të Politikave Tregtare dhe për të krijuar skeda/regjistra/arkiva të duhura;

7.2 Për Ministritë Linjë

- c. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – duhet të krijoj programe të specializuara arsimore të cilat mbështesin profesione të caktuara në konsultim të ngushtë me asociacionet dhe organizatat përkatëse të krijuara për këto profesione;
- d. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – duhet urgjentisht të inicioj procesin e Njohjes Reciproke të Diplomave me vendet e CEFTA-së dhe BE-së;
- e. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – përkatësisht ARBK duhet të kërkoj ndryshime të nevojshme në legjislacion, të cilat do të mundësojnë mbikëqyrjen e procesit të themelimit të kompanive në kategorinë e shërbimeve profesionale dhe ndërmjet forumeve për të gjitha kategoritë e zbatueshme, duke përfshirë në dokumentacionin e saj kërkesat për certifikim të diplomave të tyre, trajnime/certifikime të specializuara (n.m.tj. praktikanti kontabilist duhet të ketë diplomë ose certifikatë ekonomike/kontabiliteti) para se të hapen bizneset e reja në këtë kategori.

7.3 Për Asociacione të Bizneseve dhe Oda

- f. Asociacionet duhet të kenë një dialog të strukturuar me qeverinë, duke u bazuar në projektet e realizueshme dhe iniciativa që bazohen në prova, duke kërkuar mbështetjen e tyre, përfshirë edhe atë të donatorëve, sidomos për trajnimet dhe certifikimet e specializuara;

- g. Duhet të përmirësohet përfaqësimi i disa asociacioneve për të paraqitur numër më të lartë të bizneseve dhe individëve, duke iu dhënë atyre kredibilitet shtesë;

7.4 Për Negociatorët e CEFTA-së

- h. Drejtori i DT si Negociator Kryesor dhe ekipi i tij, përkatësisht Drejtori i Njesisë për Marrëveshje Tregtare, i cili paraqet nevojën e Kosovës për të vazhduar konsultimin e brendshëm me të gjitha palët e interesit (ministritë/asociacionet) për të adresuar të gjitha aspektet që ndikojnë në negociatat për shërbime profesionale në nivel të CEFTA-së;
- i. Të formohet Grupi Punues Kombëtar për Shërbime Profesionale, si forum i specializuar për të adresuar çështjet kyçe në të cilat haset gjatë procesit të negocimit;
- j. Të dëshmohen të gjitha diskutimet dhe të krijohen regjistrat e çështjeve për t'i gjetur dhe vazhduar me to me institucionet/asociacionet përkatëse, përfshirë lehtësimin e referimit në fazë të mëvonshme;

8 LITERATURA

- ☒ Banka Qendrore e Kosovës (2014). *Bilanci i Pagesave*.
- ☒ Komisioni Evropian – Dokumentet Ekonomike 533 | Shtator 2014 Çështjet Ekonomike dhe Financiare ‘Ndikimi Ekonomik i Liberalizimit të Shërbimeve Profesionale’ Erik Canton, Daria Ciriaci, Irune Solera
- ☒ Francois dhe Hoekman (2010). Sondazh: *Literatura e fundit empirike e cila vlerëson efektet e tregtisë dhe konkurrencës më të madhe në prodhimtarinë e firmave që shfrytëzojnë shërbimet dhe inputet*.
- ☒ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK 2010 – 2013)
- ☒ Lehmann, Alexander; Tamirisa Natalia dhe Wiczorek Jaroslaw (2003). Tregtia e Shërbimeve Ndërkombëtare: *Implikimi për FMN. Dokumenti i diskutimeve për FMN, PDP/03/06, Dhjetor*.
- ☒ Lücke, Matthias; Spinanger, Dean (2004). Liberalizimi i tregtisë së shërbimeve ndërkombëtare: *Sfidat dhe mundësitë për vendet në zhvillim, Kieler Diskussionsbeiträge, Nr. 412*.
- ☒ Mattoo, A. dhe L. Payton (2007). *Tregtia e Shërbimeve dhe Zhvillimi: Përvoja e Zambisë*, Washington D.C.: Palgrave dhe Banka Botërore.
- ☒ Baza e të Dhënave mbi Tregtinë e Shërbimeve (2012-2014). Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Kosovë.
- ☒ Organizata Botërore e Tregtisë (2011-2013). *Të Dhënat mbi Tregtinë Ndërkombëtare*.
- ☒ Organizata Botërore e Tregtisë (2013). *Të Dhënat mbi Tregtinë Ndërkombëtare dhe Qasjen në Treg*.
- ☒ Raporti për Tregtinë Botërore i OBT (2004). *Rëndësia e Infrastrukturës për Tregti dhe Zhvillim*.